



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
SEKTORI EKONOMIK DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

URDHËR

Nr. 31, datë 12.03.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 31, DATË 11/03/2020, TË DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE, "PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE ORGANIZATIVE DHE ADMINISTRATIVE NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE, NË KUADËR TË PARANDALIMIT TË PËRHAPJES SË VIRUSIT COVID-19" DHE SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 32, DATË 11/03/2020, TË DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Bazuar në nenet 5 dhe 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, nenin 28, gërma "d" të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", nenin 7 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 132, datë 8.3.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura" të nxjerrë në kuadër të masave parandaluese për sëmundjen infektive (COVID-19),

URDHËROJ:

1. Në urdhin nr. 31, datë 11/03/2020, të bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:
 - a. Në pikën 1, togfjalëshi "me përjashtim të procedurave me numër 2601-2920", shfuqizohet.
 - b. Pika 2, ndryshohet me përmbajtjen si vijon:
- "2. Rritjen e masave higjienosanitare në të gjitha mjediset e punës së DAP-it, si dhe dezinfektimin e ambienteve të brendshme të godinës."

2. Urdhri nr. 32, datë 11/03/2020, i Drejtorit të Departamentit të Administratës Publike, “Për miratimin e masave në lidhje me zhvillimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit COVID – 19”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të DAP-it e afishohet në hyrje të ambienteve të tij.

DREJTOR DEPARTAMENTI

Albana Koçiu

